

EKSTRAKT

NGA VËLLIMI “HORIZONTE ETNOKULTURORE”, BOTIMI I DYTË, TIRANË 2021, 1131 FAQE

Vëllimi “Horizonte etnokulturore” shënon të 20-tin dhe të fundit të botimeve të mia gjatë një periudhe 44-vjeçare, 1976-2020. I trajtuar me nocionet emërtuese *horizonte dhe etnokulturore*, sigurisht që dëshmon për një gjithësi materiale dhe shpirtërore të traditave tona, në vështrimin *etnografik, folklorik, antropologjik, gjeografik, historik dhe psikologjik*. Rrjedhimisht, përmes “Horizonte etnokulturore” jam përpjekur të parashtoj njëfarë universi në zhanrin artistiko-shkencor të kulturës popullore kombëtare.

Shpreh kënaqësi të dëshmoj se **identitetet etnokulturore shqiptare** i kam të personifikuara përmes trojeve në: 1- *Shqipëri*, 2- *Kosovë*, 3- *Çamëri*, 4- *Shqiptarët në Maqedoni*, 5- *Shqiptarët në Malin e Zi*, 6- *Arbëreshët e Italisë*, 7- *Arvanitët në Greqi*, Diaspora në: 8- *Mandrica të Bullgarisë*, 9- *Zarë të Kroacisë*, 10- *Shqiptarët e Vjetër të Ukrainës* (Të shumtët e këtyre identiteteve do të përbënin troje shqiptare jashtë shtetit, por **brenda Atdheut**).

Në këtë hulli do të reflektonin edhe **përjetime të kahershme dhe aktuale në shtetet**: *Bullgari, Hungari, Çekoslovakia, Poloni, Rumani* (1950); *Bashkimi Sovjetik dhe Republika Demokratike Gjermane* (1951); *Kinë, Kore dhe Vietnam* (1965- 1966); *Mali i Zi* (1972); *Maqedoni* (1974); *Turqi* (1980); *Greqi* (1984); *Itali* (1990); *Bosnje Hercegovinë* (1993); *Arabia Saudite* (1998); *Austri* (2000); *Spanjë* (2006); *Francë* (2008); *Mauritani* (2009); *Kroaci dhe Serbi* (2013); *Emiratet e Bashkuara Arabe* (2016); *Danimarkë, Norvegji dhe Suedi* (2016); *Ukrainë* (2019). Së fundmi, e përhershëmja Zvicra, si atdheu i mbesës Elisabeth. Këto, përfshirë edhe qytete e treva të tjera, brenda dhe jashtë Shqipërisë, përmes ekspeditash, gjurmimesh ose investigimesh, të cilat më kanë lënë mbresa, disa drejtpërsëdrejti përmes ngulimeve burimore dhe disa të tjera si ogurmire shpirtërore, do të ishin: **96** qytete në **33** shtete të **3** kontinenteve- **Europë-Azi-Afrikë**.

Lënda e vjelur nga këto oaze unikale, *artikulluar drejtpërsëdrejti*

ose *anashkalimthi si jehonë meditative*, është përfshirë sipas periudhave përkatëse në studimet dhe botimet e mia të 19–të *vëllimeve pararendëse*, 1976-2013 (Me përparësi korpusi” **Etnokoreografi**”, në gjashtë vëllime). Kurse ajo e pesë viteve të fundit, 2016-2020, ka përbërë strumbullarin e vëllimit objekt **“Horizonte etnokulturore”** me një volum prej 1483 faqe (nga botimi i parë). Ky botim ka përfshirë rreth **40 ekspedita, investigime, festivale, tubime apo rrugëti në terren**, brenda dhe jashtë Shqipërisë. Vëllimi flakadon nga vllaga e pararendësve.

Ç’është më e rëndësishme dhe ndryshe nga botimet e mëparshme, lënda dhe përgjithësisht të konceptuarit e këtij vëllimi sikur e personalizojnë fizionominë e figurës sime me atë të *krijuesit në fushën e artit dhe eksploruesit e studiuesit në fushën e shkencës*. Kësisoj, problematika do të rrokte kahje simptomash edhe nga të **shkencës albanologjike**.

Për një komunikim më të drejtpërsëdrejtë, preferova që *ekstrakti* t’i referohej paraqitjes së çdo kapitulli përfshirës, nga XXI të tillë, përmes të cekurit përgjithësues të kuintësencës së tyre.

I. Baleti shqiptar në periudhën 1950-1973

Oponencë për gradën “Doktor i shkencave” të disertantes Roberta Mone Ndokaj, (Janar 2016)

Kjo temë shënon oponencën e parë për mbrojtje doktorature në fushën e artit koreografik shqiptar. Disertacioni rrok një lëndë të gjerë të organizuar në pesë kapituj me 223 faqe, teksa bëhet objekt veprimtaria e baletit shqiptar gjatë një periudhe 23- vjeçare. Autorja përfaqëson të qenit pedagoge në fushën e koreografisë në Universitetin e Arteve në Tiranë.

Janë në objekt nismat e artit koreografik shqiptar përmes *“Baletit të vogël”* pranë Filarmonisë Shqiptare (1950) e deri te baletet shqiptare dhe ndërkombëtare të kultivuara në Teatrin e Operas dhe të Baletit të Shqipërisë.

Mbrojtja u krye në *Institutin e Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit* në Tiranë. Juria e vlerësoi disertacionin me **98 pikë, “Shumë mirë”**

II. Meditim

Mbi intervistën e botuar në revistën “Sharri”, Opojë-Kosovë:

“Ramazan Bogdani – studiues emblemantik i valleve shqiptare”, (Nëntor 2016)

Lënda rrok një ekspeditë kërkimoro-shkencore të para 36 viteve të zhvilluar në vitin 1979 në Opojë-Kosovë (së bashku me *Agron Xhagollin* dhe *Fatmir Vaqarrin*). Trajtesat paraqiten në formën e një interviste nga **Ramazan Fetahu**, nga Opoja, student në shkollën e lartë “Hëna e plotë” (Bedër), Tiranë, 31 tetor 2015.

Në këtë shkrim, ashtu anashkalimthi, evokohet edhe për një ekspeditë pararendëse në Kosovë në vitin 1972, e realizuar së bashku me kolegët folkloristë **Jorgo Panajoti** dhe **Beniamin Kruta**. Gjatë kësaj ekspedite shquan edhe pjesëmarrja e figurës shumë të njohur për shkencën dhe kulturën kosovare, Prof. **Anton Çetta**.

III. Timoleo Papa Pas 58 vjetësh në Shqipëri (Mars dhe dhjetor 2016)

Largohet nga Shqipëria si i arratisur në gusht të vitit 1957 dhe kthehet si vizitor pas 58 vitesh, në qershor 2015.

Ky artikull-kapitull është realizuar përmes tri dokumentacionesh. *Së pari*, nga botimi i dy shkrimeve në gazetën “Telegraf”-Tiranë, gjatë ardhjes së tij si vizitor në Shqipëri. *Së dyti*, nga rrëfimet e Timoleos në Tiranë për një ngjarje aq të ndjeshme në ato vite. *Së treti*, nga meditimet e shumta për Timoleon kryesisht gjatë tri vajtjeve të mia në Athinë, pas viteve ‘90.

Gjatë këtij **burimi shkrimor** operohet edhe përmes një figure madhore të baletit botëror, **Rudolf Nurejev**, një koleg ky kryesisht gjatë periudhës dhjetëvjeçare studimore dhe artistike të Timoleos në *Nju Jork të Amerikës, me atributet e nënshtetasit amerikan*.

Timoleo Papa ka qenë pjesë e masonërisë universale me gradën “**Mjeshtër i Lartë**”.

Me dhimbje të thellë bëhet me dije se më 21 maj 2016 Timoleo u nda nga jeta në Athinë.

IV. Saga Hasan Bogdani (Mars dhe dhjetor 2016)

Rreth jetës së **Babë Hasan Bogdani** (1900-1967). Operohet kryesisht përmes veprimtarive *artizanale dhe tregtare*. Ravijëzohet më së shumti periudha e parë e jetës deri në vitin 1944 dhe pjesërisht e dyta, e *skamjes*, pas vitit 1944. I fiksuar është fakti se në vitin 2003, përmes një ceremoniali dinjitoz, është realizuar dhe përruar njëherësh basorelievi i bronzit për Babën, vepër nga **Niko Thomo** (“*Artist i merituar*”), i trajtuar në një

pllakat metalik dhe i vendosur në ballinën e pallatit, ish- shtëpia jonë. Basorelievi zbardh me motivacionin “*Mirënjohje të pakufishme Babait tonë të paharruar Hasan Bogdani*”-Familja, Tiranë 2003.

Veçon në këtë shkrim gjyshi im, **kryepleqnari** “*Rom Efeniu*”, atribues me titullin “*Mirënjohje e qytetit të Tiranës*” dhe emrin e të cilit, pushteti vendor ia ka vendosur rrugës së një lagjeje në Tiranë, rruga “*Ramazan Bogdani*”.

Një vend të konsiderueshëm, si pjesa e dytë e këtij artikulli, zënë “*Skemat demografike*”. Ato përfshijnë gjashtë brezni, nga **Xhaferr Bogdani**, i pari para 205 vjetësh e deri tek e fundit, **Elisabeth** që është 108 ditore (trimujore).

V. Te shqiptarët në Malin e Zi

Investigime për manifestime popullore në Plavë-Guci-Tuz-Krajë – Shestan (Gusht 2016)

Janë trajtuar në sferën investiguese tradicionet etnokulturore të pesë ngulimeve shqiptare në Malin e Zi. Posaçërisht do të veçoja **zonën e Shestanit** që ka qenë një objekt tejet i rëndësishëm në vëllimin tim “**Diaspora etnokoreografike**”, Tiranë 2013, 436 faqe.

Në këtë shkrim është klikuar në formën e një epilogu organizimi në ato anë të shqiptarëve në disa festivale apo manifestime popullore, si: “Mirësevini në Alpet e Shqipërisë” (Vuthaj), “Maja e karafilit” (Plavë-Guci), “Festivali i folklorit mbarëkombëtar i Tuzit”, “Vallja e Shestanit, “Vallja e gështenjave”, “Ditët e diasporës shqiptare”.

VI. Në të 18-in Festival Folklorik Ndërkombëtar

(Me ansamblin “Tirana”, Slloveni, shtator 2016)

Trajtohen gjerësisht në rrafshin e problematikës folklorike, *autentikja* me *bashkëkohoren*. Janë në objekt tri ansamblt pjesëmarrëse, nga *Shqipëria*, *Estonia* dhe *Rusia*, njëherësh edhe tri ansamble vendase, përkatësisht nga qytetet *Velenjë*, *Celje* dhe *Zhalec*. Përsa areolin e traditave tona kombëtare, përmes ansamblit “*Tirana*” relaksohet slogani “*Folklori –taml i gjinit të nanës*”. Veçojnë bashkëbisedimet me tre titullarë të atyre ansambleve: **Rudina Demaliaj** (Shqipëri), **Marg Lits Sepp** (Estoni) dhe **Ivanova Natalia Viktorovna** (Rusi).

Gjatë këtij festivali ndërkombëtar ishte në objekt edhe ndjekja e një

veprimtarie tjetër ndërkombëtare, “*Manifestimi i 46-të – Populli ynë*”, i zhvilluar në qytetin slloven *Kamnik*. Në këtë festivitete, veç tri ansambleve pjesëmarrëse nga Shqipëria, Estonia dhe Rusia, ishin edhe tri të tjera nga Bosnjë Hercegovina, Austria dhe Italia.

VII. Hazis Ndreu Korabi i valles dyshe dibrane (Janar 2017)

I thuren lavde nga njohja dhe bashkëpunimi që kam patur me Hazis Ndreun, lëvruesit në nëntë **fusha të dijes popullore**, si: 1- *Valltar*, 2- *Instrumentist*, 3- *Rapsod*, 4- *Këngëtar*, 5- *Koreograf*, 6- *Aktor*, 7- *Historian*, 8- *Poet*, 9- *Shkrimtar*. Poetikisht këto **9 fusha** ravijëzohen me **9 malet e Dibrës** (*Reçi, Dardha, Çidhna, Muhri, Luznia, Katër Grykët, Gryka e Vogël, Gryka e Madhe, Bulqiza*). Me atributet e një krijuesi dhe interpretuesi në fushat e folklorit dhe të artit, ia kam artikulluar dijet **Haziz Ndreut** përmes dy veprave, “*Ezopi i Dibrës*” i autorit **Xhezair Abazi** dhe “*Burri i odës dibrane*” të **Bujar Kapexhiut**. Më konkretisht, jam përqendruar në **trajtesat dialogjike** me të dy autorët, *Abazi* dhe *Kapexhiu*.

VIII. Historiofestivalistika e folklorit shqiptar (Maj 2017)

Ravijëzon një dokumentacion të një rëndësie të veçantë për folkloristikën në veçanti dhe etnokulturën shqiptare në përgjithësi, ndonëse përmes ndjesive vetjake të autorit dhe mbase për herë të parë në studimet tona. **Trajtohet rrugëtimi gjashtëdhjetëvjeçar i 14 festivaleve folklorike kombëtare, 1949-2009**, duke u shenjësuar secili me një **numër** sipas **vitit të zhvillimit**. Këto veprimtari janë të legjitimuara edhe përmes kronikash, reportazhesh, filmimesh dhe një sërë dokumentacionesh.

Të 14-të festivalet percillen në këtë botim secili me dy fotografi unikalë: njëra me *pamje* festivalistike dhe tjera me një njësi folklorike.

Përmes këtij artikull-kapitulli, për herë të parë, sipas edhe dijeve të mia, bëhet objekt një listë gjithëpërfshirëse e *bartësve popullorë* dhe më gjerë që kanë pasur titujt “*Artist i Popullit*” dhe “*Artist i merituar*” gjatë periudhës deri në vitet ’90.

IX. Kcimi tropojan kurorë e vallëzimit popullor shqiptar (Maj 2017)

Përbën një artikull studimor për lashtësinë e “Kcimit tropojan”. Trajtohet në hapësirën për ta ligjësuar Ministria e Kulturës “Kcimin e bjeshkëve me tupan të Tropojës, kryevepër të trashëgimisë shpirtërore kombëtare”. Për këtë është zhvilluar në dhjetor të vitit 2016 në qytetin Bajram Curri një Konferencë Kombëtare Shkencore. Qëllimi më kryesor i asaj konference ka qenë debatimi dhe përgatitja e dokumentacionit përkatës **për ta shpallur në mbrojtje të UNESCO-s “Kcimin e Tropojës”** me titull “Kcimet si thurime e ritualeve të jetës dhe trashëgimisë shpirtërore në Tropojë” (Në atë tubim në qytetin e Bajram Currit autori ka qenë i angazhuar me një referat). **Në këtë artikull për “Kcimin tropojan” bëhen objekt edhe krijimtari koreografike tropojane të realizuara nga Panajot Kanaçi, Agron Aliaj, Gëzim Kaceli dhe Ramazan Bogdani, kryesisht përmes krijimtarive muzikore nga Çesk Zadeja dhe Tish Daija.**

X. Edhe një herë në Arbnesh të Zarës (Zadar) të Kroacisë (Prill 2017)

Nisur nga titulli, dëshmohet se në Zarë të Kroacisë kam qenë dy herë. Veprimtaria e parë shënon një ekspeditë hulumtuuese në vitin 2013 si rezultat i së cilës kam realizuar studimin “Ngulime etnokoreografike dhe historike në Arbnesh të Zarës, vendbanim me origjinë shqiptare në Kroaci”. Ky është përfshirë si kapitulli i katërt në vëllimin tim “**Diaspora etnokoreografike**”, *Vep. cit.*, f.297-402.

Veprimtaria e dytë është zhvilluar në prill të vitit 2017, pikërisht në Arbnesh të Zarës, mes të pranishmëve nga komuniteti Arbnesh i Zarës dhe nga “*Unioni i shqiptarëve*” në Kroaci, me kryetar **Esat Çollakun**. Tubimi pati për qëllim përrurimin e atij studimi, të konceptuar në formën e një *libërthi*. Ishte i pranishëm me mua edhe **Agron Sejamini**.

XI. Festivali “Aulona interfolk” (Vlorë, maj 2017)

Shënon edicionin e 9-të të asaj *veprimtarie ndërkombëtare*, e kualifikuar si e tillë nga organizata botërore CIOF. Është festival i përvitshëm, me karakter konkurrimi, vetëm me një trofe “*Kupën e festivalit*”. Deri më tani atë kupë e kanë merituar ansamblet folklorike nga *Slovenia, Bullgaria,*

Italia, Kosova, Turqia, Polonia, Shqipëria. Këtë vit kupën e fitoi *Ansambli i Bjellorusisë.* Në Festivalin e 9-të, 2017, garuan gjashtë ansamble folklorike, përkatësisht nga *Bullgaria, Çekia, Bjellorusia, Kosova, Shqipëria, Maqedonia.* Veçmas për këtë festival kam trajtuar programet përkatëse kryesisht nisur nga pozitiviteti, por edhe të ndonjëfarë problematike. Në festival morën pjesë edhe katër ansamble përshëndetëse nga Shqipëria, si: *Qendra Kulturore e Fëmijëve -Vlorë; Ansambli Folklorik i të Rriturve-Vlorë; Grupi folklorik i ansamblit “Bilbili”-Vlorë; Ansambli folklorik “Krahu i shqiptonjës Taip Madani” i çamëve të Vlorës.*

Ky artikull-kapitull është trajtuar më gjerësisht duke u përqendruar edhe në: Festivitetet gjatë festivalit; Çelja e sezonit turistik-Vlorë 2017; Parada e ansambleve; Ceremoniali përmbyllës i festivalit; Gazetë - revista “Aulona 2017” për festivalin.

Së fundmi, çka edhe më kryesorja, artikulli përshkohet nga analiza studimore rreth artit e folklorit me *karakter kombëtar dhe ndërkombëtar.*

XII. Festivali i 15-të kombëtar “Sofra dardane”, 2017 (Maj, qyteti Bajram Curri)

Është organizuar nga *Unioni Artistik i Kombit Shqiptar.* Morën pjesë 16 ansamble nga *Shqipëria, Kosova dhe shqiptarët në Maqedoni e Malin e Zi.* U përfaqësuan rreth 300 artistë popullorë, të cilët lëvruan 49 njësi koreografike, vokale dhe instrumentale.

Artikulli është analizuar përmes tri opsionesh:

Kategorizimi i parë - Folklorike (27 njësi);

Kategorizimi i dytë - Përpunime (18 njësi);

Kategorizimi i tretë - Stilizime (4 njësi).

Njëherësh bëhen objekt disa kriteret shkencore për një *festival kombëtar.*

XIII. Festivali “Këngë jeho” - Strugë, 2017 “Dhe...” (Korrik dhe tetor)

Në festival morën pjesë 16 ansamble nga Shqipëria, Kosova, shqiptarët në Maqedoni e në Malin e Zi, Luginën e Preshevës dhe Diasporë. U lëvruan 50 njësi folklorike koreografike, vokalo- muzikore dhe instrumentale. Analizat përkatëse u trajtuan përmes katër zhanresh: 1. *Vitalitet vokal,* 2. *Produktivitet koreografik,* 3. *Artikulum instrumental,* 4. *Refleksitet kostumografik.*

Vend të posaçëm ka zënë pjesa e dytë e kapitullit e përcaktuar **“Dhe...”** si çertifikuese e një kodi *“statukuo”*. Në këtë spektër përfshihen edhe përjetime sondazhesh të kahershme, përmes tri qyteteve: **Strugë - Dibër - Gostivar**.

Në këtë hapësirë, për herë të parë bëhen prezente pothuajse të gjitha ngulimet ku kam zhvilluar hulumtime dhe veprimtari shkencore e artistike. Njëherësh të tilla edhe në shtete të ndryshme të botës.

XIV. Festivali mbarëkombëtar i folklorit “Rapsha 2017” (*Gusht, Malësi e Madhe - Tuz, Mali i Zi*)

Ndodhem për herë të parë në një Festival Folklorik Mbarëkombëtar të shqiptarët në Malin e Zi. Ky festival shënon edicionin V, që zhvillohet në çdo katër vjet, duke u mbajtur në kompleksin *“Vitojë”*, 5-6 km nga Tuzi. Morën pjesë 22 ansamble me artistë amatorë shqiptarë, të cilët kishin ardhur nga shtatë shtete: Shqipëria, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia, Italia, Serbia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Festivali pati karakter garues, teksa dy ansamble ishin përsëritëse: ansambli *“Shota”* i Kosovës dhe Shoqata Kulturore Artistike *“Rapsha”* e Hotit. Festivali u zhvillua gjatë tri mbrëmjeve, duke konkurruar çdo natë nga shtatë ansamble. Këtë vit Çmimin e Parë e meritoi ansambli *“Rugova”* i Pejës - Kosovë.

Në këtë festival isha i ngarkuar edhe me detyrën e anëtarit të jurisë.

Gjatë paraditeve të zhvillimit të festivalit u angazhova në njërin nga *“tryezat e rrumbullakëta”* si edhe m'u dha rasti të kryeja dy vizita: në qytetin Cetinjë dhe tjetra në shtëpinë-muze të figurës historike Dedë Gjon Luli në fshatin *Bardhaj*.

XV. Përrurim dylibrash në “Takimet e Gjeçovit”, Zym të Hasit – Kosovë (*Tetor 2017*)

Janë në objekt përrurimet e dy vëllimeve të mia: **“Folklori koreografik i Hasit”** (në dy botime, më 1975-n e 1977-n) dhe **“Etnokoreografi kosovare hasjane”** (2005). Kjo veprimtari është zhvilluar e programuar gjatë konferencës shkencore *“Trashëgimi kanunore të shqiptarët”*, në hapësirën e zhvillimit të *“Takimet e Gjeçovit”*, Zym 2017.

Në këtë artikull - kapitull përbën objekt të veçantë historiku i botimit - 1975 dhe ribotimi -1977 i *“Folklorit koreografik të Hasit”*. Unikalja në këtë rast shfaqet përmes njëfarë autenticiteti grimcash hipnotizuese të spektrit

hyjnoro-tokësor.

Ndjesi të veçanta sjell vizita në familjen e Luz Kristajt, duke kujtuar zhvillimin për tri ditë të një festiviteti martesor të para 16 viteve.

XVI. Në një festival ndërkombëtar në Ohër dhe sondazhe e investigime në qytet Manastir – Kërçovë – Tetovë (Maqedoni, tetor dhe nëntor 2017)

Ky kapitull përfshin lëndë nga dy kahje sipas titullit përkatës.

Gjatë pjesës së parë fillimisht artikullohet një tablo rreth zhvillimeve të festivaleve folkloriko-artistike në Ohër të Maqedonisë. Në vijim analizohen programet e ansambleve pjesëmarrëse të *Maqedonisë, Bullgarisë* (me dy ansamble) dhe të *Ukrainës*.

Në pjesën e dytë, përmes tri qyteteve bëhen objekt evente të kahershme nga veprimtaritë e mia. Shprehje të veçantë do të përbënte këtu realizimi i *një harte të Maqedonisë Perëndimore*, duke përfshirë **10 vendbanime me sondazhe tradicionesh etnike shqiptare.**

XVII. 82 DVD (70 të ngarkuara në You Tube)

Në adresën zyrtare: **Ramazan - Ema - Ershela Bogdani** (Maj 2018)

Ramazani: - 50 DVD (XVI/1/1-50) +1 DVD (XVII/V)
Nga veprimtaritë artistike dhe shkencore gjatë një periudhe mbi gjysmëshekullore.

Ema: -8 DVD (XVII/II, 1-8)
Nga veprimtaritë vokalo-artistike gjatë një periudhe mbi 40-vjeçare.
- 12 cover (XVII/II. 9-20), të cilat nuk janë të ngarkuara në YouTube.

Ershela: -10 DVD (XVII/III. 1-10)
Nga veprimtaritë pianistike dhe ekzekutimet koreografike.

Ema-Ershela: - 1 DVD (XVII/IV) me këngën “Ikin stinët”.
Artikull - kapitulli përcillet me **koverat e të 82 DVD-ve.**

XVIII. Diaspora shqiptare:

1. *Arbëreshët e Italisë përmes dy kumtesave (Shtator 2018 dhe tetor 2019)*
2. *Shqiptarët e vjetër të Ukrainës përmes dy investigimeve etnokulturore (Fillim tetori -2019- fundtetori)*

Ky kapitull do të flakadonte në hullinë e vëllimit tim **“Diaspora etnokoreografike”**, *Vep. e cit.* Njëtrajtshmëria e tyre qëndron ngase shqyrtohen ngulime të etnisë shqiptare në disa shtete. I pari (Vëllimi i vitit 2003) përmes katër ngulimeve, në *Bullgari, Kroaci, Itali, Maqedoni*, kurse i dyti (Vëllimi i vitit 2020) me dy, *Itali dhe Ukrainë*.

Kapitulli objekt nuk rrok vetëm një fushë, siç është *etnokoreografia*, por një të tillë *gjithëpërfshirës, memorizues e investigates*, në përshtatje me specifikën e vëllimit objekt ku trajtohet kapitulli përkatës.

Përsa i përket Ukrainës, rroken tri nga katër fshatrat përbërës: *Tazi, Qushkia, Gjandran*. Këtë dukuri autori e ka cekur paksa edhe në vëllimin **“Diaspora etnokoreografike”** (f. 76-82), duke spikatur edhe fshatin e katërt, më kryesorin, Karakurt. Në këtë spektër do të shpaloset edhe një veprimtari koncertale në qytetin Odesa, nga Ansambli i Këngëve dhe Valleve Popullore të Shqipërisë për shqiptarët e Ukrainës.

XIX. Veprimtari shkencore - artistike - shoqërore

Gjatë periudhës tetëvjeçare, 2013 – 2020

Siç duket edhe nga titulli, vetëm ky kapitull e shënon nismën jo sipas përfshirjes së lëndës, më 2016-n, por tri vite më herët, më 2013-ën.

Trezërëshi (shkencore - artistike - shoqërore) i këtij kapitulli mund të vështrohet në dy etapa. *E para, 2013 - 2017*, përshtatur nga një tematikë shumë e gjerë, në natyrën e një *artikulimi të perifrashuar*. Këtu do të veçonim refleksionet në shtatë shtete: *Serbi, Republikën Çeke, Gjermani, Danimarkë, Norvegji, Suedi, Hungari* (Paraprakisht në *Moskë dhe Shën Petërburg* të Rusisë).

Kurse etapa e dytë, 2018-2020, shquan për trajtesat analitike dhe ngulimet me analizat përkatëse në 22 etnitete, sipas rendit kronologjik: Prishtinë, Elbasan, Durrës, Shkodër, Korçë, Pogradec, Sarandë, Berat, Fier, Vlorë, Peshkopi, Burrel, Dragash, Zhur, Viti, Rajçë e Librazhdit, Gjirokastrë, Tepelenë, Përmet, Gramsh, Kukës, Shishtavec.

Fundi i kapitullit XIX përfshin një event të jashtëzakonshëm: **Ema**

Qazimi Bogdani në skenë pas 20 vitesh. E ftuar në Festivalin e 58- të Kombëtar të Këngës në Radio Televizionin Shqiptar me këngën “*Shqipëri o vendi im*”. Ishte ky një personifikim *i jetës së saj artistike 40- vjeçare me rreth katër mijë këngë.*

XX. **Rrugëti medituese në shtatë qytete dhe tri evente (2019).**

Siç shihet edhe nga titulli, ky artikull përbëhet nga dy pjesë.

Gjatë pjesës së parë operohet përmes shtatë qyteteve, brenda dhe jashtë Shqipërisë. Veprimtaritë janë zhvilluar jo përmes ekspeditave, por të tillave, të njëfarë opsioni unikal meditues, të realizuara vetëm gjatë kohës së ndodhjes në ato anë. Janë në objekt: *një ekspeditë kërkimore shkencore* (Hasi i Shqipërisë, 1970), *dy veprimtari festivalistike* (Çorovoda e Skraparit - 1988 dhe Erseka e Kolonjës -1973), *një spektakël koncertal* (Filati i Çamërisë në Greqi - 1984) dhe *tri përkujtesa ngulimesh* (Lezhë 1972, Preshevë 2010, Shkup 1999).

Pjesa e dytë e artikull-kapitullit XX përfshin tri evente. *I pari*, ka në epiqendër një turne artistik në Kinë, Kore, Vietnam (1965 - 1966). *I dyti* përshkon dhjetë rrëfenja nga përjetimet e mia me Prof. **Alfred Uçin**. *I treti*, trajton festivitetet e pesë ditëlindjeve tona familjare (*Elisabeth, Ema, Ramazan, Ershela, Frederik*) në Rolle të Zvicrës dhe në Tiranë.

XXI. **Mëkuar nga baltëmjalta Tiranë, 1940-1952 (Mars-qershor 2020)**

Artikull-kapitulli XXI në librin e 20-të “**Horizonte etnokulturore**”, shënon edhe fundin e tij, ama një fund që vezullon nga **numri 20** i botimeve të mia. Ndaj, le të zbardhë ai edhe si i tillë. Fillimisht objekt qendror do të ishte **Tirana**. Si çun prej një familjeje të vjetër të Tiranës, do të dëshiroja që të zbardhja disa nga *reliktet* e saj. Dhe pikërisht, është Tirana e themeluar më 1614 -n, e shpallur kryeqytet më 1920 -n, e 39000 banorëve në vitin 1938. Është Tirana e rrethuar nga dhjetëra kala, me lumenj, përroje e livadhe, me tradicione blektorale, bujqësore e artizanale, e cila nisi të konsolidohej si një *komunitet tiranas*. Është Tirana, kryesisht *qendra* dhe *Lagjja e Re*, e cila me rikonstruksionin në vitin 1929, në sajë të ideve nga disa urbanistë të mëdhenj italianë e botërorë, nisi të marrë pamjen e *një qyteti mesdhetar, modern dhe botëror*. Është Tirana e asokohshme me:

13 librari; 25 shtypshkronja; 130 gazeta e revista; 25 kinema; 13 foto - studio; 70 hotele e hane; 80 restorante e bar- bufe; 15 konsullata të huaja.

Përsa hullinë e librit objekt, do të shënohen për Tiranën edhe: *dhjetëra grupe teatrale; disa grupe vokalo - artistike; dy-tri atelie të arteve; deri edhe dy-tri salla për të mësuarit e dancit modern. Tirana kishte arritur stade të konsiderueshme deri aty sa disa trupa artistike botërore kanë shfaqur operat: “Traviata”, “Toska”, “Berberi i Seviljes”, “Rigoletto”, “Bohema”.*

*Së fundmi, duke qenë se ajo ishte e pajisur me **virtyte të tilla morale**, si: besa, mikpritja, urtia, mençuria, bamirësia, toleranca, komuniteti tiranas reflektoi **prioritete traditash bujarie dhe fisnikërie.***

Duke iu kthyer artikull - kapitullit objekt, gjatë këtij pesëvjeçari të proceseve përgatitore të këtij libri (2016-2020) kam medituuar së shumti për të shigjetuar njëfarë *horizonti autobiografik* kryesisht për nismën e jetës sime. Madje, këtë plazmim do ta bëja me përkushtim, për më tepër që një tematikë të tillë po e trajtoj për herë të parë. Me këtë kam parasysh kryesisht tri periudha jetësore: *fëmijërinë - adoleshencën – fillesat rinore*, gjatë një kohe dymbëdhjetëvjeçare (1940-1952).